

ZËRI I QYTETARËVE PËR QEVERISJE TË MIRË

HULUMTIM: PJESËMARRJA E QYTETARËVE
NË VENDIMMARRJE – KOMUNA E ULQINIT



NEW HORIZON
Civil Society Organization



Ministarstvo javne uprave

Titulli i publikimit:
ZËRI I QYTETARËVE PËR QEVERISJE TË MIRË



NEW HORIZON
Civil Society Organization

Botues:

OJQ „Horizonti i Ri“

Ulqin

Tel: +382 68 300 603

E-mail: horizon@t-com.me

www.ngo-horizonti.org

 newhorizonngo

Për botuesin:

Nazif Veliqi

Bashkëpunëtorë në procesin e anketimit:

Aleksandra Pëgjoni, Diandra Koçan, Ivana Dashiq, Maja Lagator

Marina Marlukiq, Nikoleta Shkreli, Samra Gjeloheviq

Sanja Causheviq, Shaban Manxhukiq, Tijana Popoviq

Konsulencia profesionale:

Hakile Resulbegoviq

Mustafa Canka

Allmir Çausheviq

Lektura dhe korrektura:

Adriana Hoxha

Faqesja dhe dizajni:

Allma Sulejmanoviq

Shtypi:

Press Studio (Ulqin)

Ulqin, korrik 2020.

Ky hulumtim paraqet një pjesë të projektit “ZËRI IM NË KOMUNËN TIME”, të cilin e realizon OJQ Horizonti i Ri në partneritet me OJQ “Ul info” dhe Bibliotekën e Qytetit – Ulqin. Projekti mbështetet nga Ministria e Administratës Publike e Malit të Zi, në kuadër të programit “e-Demokracia – merr pjesë, propozo, ndrysho”, në fushën e reformës së administratës publike.

Përmbajtja e këtij publikimi është përgjegjësi vetëm e autorit dhe në asnjë mënyrë nuk pasqyron qëndrimet e donatorit.



NEW HORIZON
Civil Society Organization



Ministarstvo javne uprave



OJQ "Horizonti i Ri", në kuadër të projektit **"Zëri im në komunën time"**, ka realizuar hulumtimin, i cili është mbështetur nga Ministria e Administratës Publike e Malit të Zi. Fokusi i këtij hulumtimi të opinionit publik ishte matja e besueshmërisë së qytetarëve ndaj Vetëqeverisjes Lokale, si dhe vlerësimi i bashkëpunimit Komunë – qytetar.

Besimi i qytetarëve është shqyrtuar përmes perceptimit të pikëpamjeve që kanë të bëjnë me: shkallën e informimit të qytetarëve rreth aktiviteteve të ndërmarra nga Komuna e Ulqinit, nivelin e informimit për aktivitetet e kësaj vetëqeverisjeje lokale; në lidhje me faktin nëse qytetarët kanë pasur mundësi dhe në çfarë mënyre kanë mundur t'i prezantojnë nevojat e tyre në lidhje me organet vendore, pjesëmarrjen e qytetarëve në procesin e vendimmarrjes për temat që përbëjnë interes të veçantë për ta, besimin e përgjithshëm të qytetarëve për punën e këshilltarëve të përbërjes aktuale të Parlamentit Lokal dhe Kryetarit të Komunës së Ulqinit.

Me ndihmën e këtij hulumtimi² është dashur po ashtu të vlerësohet sa janë banorët e komunës së Ulqinit të njoftuar me mekanizmat përmes të cilëve mund të marrin pjesë drejtpërdrejt në procesin e vendimmarrjes së Vetëqeverisjes Vendore.

Hulumtimi është kryer në një mostër të volitshme prej 235 anketimesh. Grumbullimi i të dhënave është kryer përmes metodës PAPI (The Pen-and-Paper Personal Interview – Anketimi me laps dhe letër) dhe përmes anketimit online (pyetësorit Google Forms), në përpjesëtim 40:60. Kohëzgjatja mesatare e plotësimit të pyetësorit ishte afërsisht pesë minuta.

Grupi i synuar i këtij hulumtimi ishin qytetarët e komunës së Ulqinit që nga moshën 18 vjeç e lart. Mbledhja e të dhënave është realizuar nga anketuesit, të cilët iu nënshtruan trajnimeve adekuate për intervistime në terren, ndërsa periudha e grumbullimit të të dhënave zgjati nga muaji mars deri në muajin maj të 2020-ës.

Projekti "Zëri im në komunën time" përveç pjesës hulumtuese, ka përfshirë edhe trajnime të ndryshme për të rinjtë në komunën e Ulqinit. Aktivistët rinorë që ishin pjesë e këtij projekti, patën mundësinë që gjatë kohëzgjatjes së projektit të njihen me tema të ndryshme dhe të marrin pjesë drejtpërdrejt në to. Krahas ciklit edukativ u organizuan vizitat e të rinjve në organet e Administratës Lokale dhe Kuvendin e Komunës. Përgjatë këtyre aktiviteteve, pjesëmarrësit e programit kishin mundësi të marrin informacion të drejtpërdrejtë nga Kryetari i Kuvendit në lidhje me atë se si formohet Parlamenti Lokal, si është struktura e tij, cilat janë kompetencat dhe funksionet e Kuvendit, si merren vendimet e ngjashme. Po ashtu, aktivistët e rinj mbajtën një sesion parlamentar jozyrtar, duke i bërë pyetje të drejtpërdrejta Kryetarit të Kuvendit, debat ky që përçoi një shembull pozitiv të 'dëgjimit' të zërit të të rinjve, gjë kjo që duhet të bëhet një praktikë e mirë gjatë kohëzgjatjes së mandatit të këshilltarëve lokal.

Gjithashtu, aktivistët e rinj patën mundësinë të vizitojnë edhe organet e Qeverisjes Vendore të Komunës së tyre. Nikoqirë të atij takimi ishin udhëheqësit dhe zyrtarët e Sekretariatit për Administratë dhe Veprimtari Shoqërore dhe të Byrosë Qytetare. Përmes kësaj vizite, aktivistët rinorë u njohën me mekanizmat e pjesëmarrjes qytetare në procesin e vendimmarrjes, me atë se çfarë janë shqyrtimet publike dhe si zhvillohen ata, si realizohet e drejta për qasje të lirë në informacionet që posedojnë organet e Komunës, si dhe cilat shërbime i ofron Byroja Qytetare.

¹ Projekti "Zëri im në komunën time" është realizuar në partneritet me OJQ "Ul info" dhe Bibliotekën e Qytetit (të Ulqinit), me mbështetjen financiare të Ministrisë së Administratës Publike në kuadër të programit "e-Demokracia – merr pjesë, propozo, ndrysho", në fushën e reformës së administratës publike.

² Një mostër e këtij hulumtimi, sipas planifikimit, është dashur të përfshijë të gjithë territorin e komunës së Ulqinit. Për shkak të situatës së krijuar, gjegjësisht shfaqjes së pandemisë COVID-19, anketuesit ishin të detyruar të pezullojnë punën në terren dhe të respektojnë masat e sigurisë, të lëshuara nga Instituti i Shëndetit Publik, Trupi Nacional Koordinues (TNK) i Qeverisë së Malit të Zi. Anketuesit kanë punuar rreth dhjetë ditë në terren, ku më pas hulumtimi ka vazhduar përmes anketimit online.

Metodat e hulumtimit

Studimi pilot dhe trajnimi i anketuesve

Para fillimit të fazës së “grumbullimit të të dhënave”, organizatorët realizuan një hulumtim pilot. Qëllimi i këtij hulumtimi ishte që përmes 15 qytetarëve të intervistuar (të cilët kishin mundësinë të bëjnë komente dhe të japin sugjerime direkte për pyetësin), të kryhet testimi paraprak i pyetësit, gjegjësisht instrumentit, i cili do të shërbente si mjet për të mbledhur të dhënat kryesore për realizimin e këtij studimi. Kjo bëri të mundur formulimin sa më të qartë të pyetjeve, sigurimin e kuptueshmërisë “maksimale” të pyetjeve për të anketuarit tanë, ndërsa në rastet kur u ndeshëm me paqartësi, pyetja e caktuar u modifikua.

Pas përfundimit të studimit pilot, OJQ “Horizonti i Ri” publikoi në web-faqen e vet Thirrjen publike me të cilën kërkonim të rinj nga Ulqini, të cilët do të merrnin pjesë në projekt në rolin e anketuesve. Përgjigjja ndaj thirrjes publike ishte e kënaqshme, ndërkaq secili kandidat i paraqitur duhej të ndiqte trajnimin intensiv dyditor për anketues.

Qëllimi i ditës së parë të trajnimit ishte njohja e anketuesve me anën teorike të “procesit të mbledhjes së të dhënave”, në të cilën u trajtuan temat në vazhdim: udhëzime për anketues, vendosja e kontaktit të parë me të anketuarin, bërja e pyetjeve nga pyetësi, nxitja e bisedimit, shënimi i përgjigjeve dhe përmbyllja e intervistimit. Në fund të trajnimit, pjesëmarrësve iu është dhënë pyetësi me vete, në mënyrë që në shtëpi të mund të njiheshin më mirë me të.

Qëllimi i ditës së dytë të trajnimit ishte praktik. Në fillim pjesëmarrësit kaluan përmes një përmbledhjeje – debriefing (ku përkujtuan punën e ditës paraprake të trajnimit), më pas trajtuan temën që kishte të bënte me “gabimet më të shpeshta që bëjnë anketuesit”, e një pjesë e mirë e trajnimit u fokusua në “role play”, gjegjësisht lojën në role, ku pjesëmarrësit anketuan njëri-tjetrin dhe njëkohësisht ishin nën vëzhgimin e trajnerëve.

Me përfundimin e trajnimit, organizatorët së bashku me trajnerët, përzgjedhën anketuesit për realizimin e punës në terren.

Pyetësi – Instrumenti

Me qëllim të grumbullimit të të dhënave për hulumtim, u përdor pyetësi i përbërë nga 14 pyetje, ku shumica ishin të tipit të mbyllur. Në krye të pyetësit ishte hyrja e shkurtër:

NEW HORIZON
Civil Society Organisation

ZA MOJ GLAS U MOJOJ OPŠTINI!

Ministartvo javne uprave

PYETËSOR PËR QYTETAR

I nderuar qytetar i komunës së Ulqinit,
Me këtë pyetësor që të ofrohet, dëshirojmë të hulumtojmë gjendjen aktuale në fushën e “pjesëmarrjes së qytetarëve në procesin e vendimmarrjes” në Komunën tonë.
Kjo anketë është pjesë e projektit “Zëri im në Komunën Time”, të cilit u realizon OJQ Horizonti i Ri me mbështetjen e Ministrisë së Administratës Publike të Malit të Zi. Projekti realizohet në kuadër të programit “e-Demokracia – merr pjesë, propozoj, ndryshoj”, në fushën e reformës së administratës publike.
Anketimi është plotësisht anonim!
Me këtë rast, ju ftojme edhe juve që të plotësoni këtë pyetësor dhe të kontribuoni në pasqyrimin sa më real të situatës, në aspektin e lartpërmendur.
Ju falënderojmë për mirëkuptimin!

Pas kësaj hyrjeje të shkurtër vijuan pyetjet, në të cilat të anketuarit u përgjigjën.



Mostra dhe procedimi i mbledhjes së të dhënave


Me rastin e hulumtimit të kryer për nevojat e këtij projekti, u shfrytëzua metoda e grumbullimit të të dhënave parësore duke përdorur pyetësin. Rezultatet e hulumtimit u nxorën me grumbullimin e të dhënave në terren dhe përmes përdorimit të formularit të internetit, pyetësit „Google Forms”. Hulumtimi ka përfshirë 235 qytetarë të Komunës së Ulqinit, në raportin 60:40, që do të thotë se 60% e të anketuarve (që përbën 141 persona) janë anketuar online, kurse 40% e të anketuarve (94 persona) kanë plotësuar pyetësin gjatë punës në terren (pyetësin face to face – ballë për ballë). Mostra, gjegjësisht përzgjedhja e të anketuarve ishte rastësore, që do të thotë se çdo qytetar i komunës së Ulqinit ka pasur mundësi të barabarta për të marrë pjesë në hulumtimin në fjalë.



Rezultatet e hulumtimit




Ju personalisht, sa jeni i interesuar për punën dhe funksionimin e Qeverisjes Vendore në Komunën e Ulqinit?



Bazuar në këtë pyetje, është dashur të ekzaminohet niveli i interesimit të qytetarëve të komunës së Ulqinit për punën dhe funksionimin e Qeverisjes Vendore. Gjithsej **73,1%** e qytetarëve (shuma kumulative e përgjigjeve "mjaftueshëm i interesuar" dhe "shumë i interesuar") u deklaruan se u intereson puna dhe funksionimi i Qeverisjes Vendore, ndërsa vetëm **26,9%** e të anketuarve (shuma kumulative e përgjigjeve "aspak i interesuar" dhe "jo shumë i interesuar"), kanë theksuar se nuk u intereson puna dhe funksionimi i Qeverisjes Vendore të Komunës së Ulqinit.

Duke u mbështetur në këtë që sapo thamë, mund të përfundojmë se pothuajse për ¾ e të anketuarve ekziston njëfarë interesimi për funksionimin e Qeverisjes Lokale, gjë që mund të përkthehet si një interesim i lartë i qytetarëve për ngjarjet në komunën e Ulqinit. Përqindja prej 26,9 nuk është befasuese sepse përmes saj mund të tërhiqen dy kahe interesimi: njëri kah që nga qeverisja vendore preferon të kalojë në nivelin shtetëror ose ndërkombëtar, kurse kahu tjetër pasqyron një mosinteresim relativ të qytetarëve.

Pavarësisht sa jeni i interesuar, në çfarë mase jeni i informuar për aktivitetet (me interes publik) që ndërmerr Komuna e Ulqinit?



Pjesa më e madhe e qytetarëve të anketuar (53,4%) konsiderojnë se nuk janë të informuar për aktivitetet me interes të përbashkët të ndërmarrë nga Vetëqeverisja Vendore, derisa 44,3% e të anketuarve konsiderojnë se kryesisht janë të informuar. Vetëm 2,4% e të anketuarve pohojnë se janë plotësisht të informuar. Kjo e dhënë na tregon se Komuna e Ulqinit duhet të ndërmarrë hapa shtesë për një informim më të mirë dhe më efikas të qytetarëve në lidhje me aktivitetet që ajo kryen në interes të komunitetit lokal.



Në hulumtimin "Pushteti vendor në shërbim të qytetarëve" të realizuar në vitin 2004 nga OJQ Horizonti i Ri, 66% e të anketuarve deklaruan se nuk kishin informacion të mjaftueshëm për aktivitetet e realizuara nga Komuna e Ulqinit. Përkundër faktit se përgjatë 16 viteve përqindja e qytetarëve të informuar është rritur, në këtë fushë ka akoma mjaft hapësirë për përmirësime. Fakti që pothuajse gjysma e të anketuarve janë kryesisht ose plotësisht të painformuar për aktivitetet e Komunës është patjetër shqetësuese. Një nga arsyet e mosinformimit të qytetarëve mund të jetë mosrespektimi i normave kushtetuese dhe ligjore, përkatësisht përdorimit zyrtar të gjuhës së popullatës shumicë (në këtë rast gjuhës shqipe) nga Vetëqeverisja Lokale.³ Raporti monitorues me titull "Gjuha e administratës sime (2019)"⁴ tregoi se Komuna e Ulqinit, në webfaqen e saj pjesërisht i publikon informacionet me rëndësi publike në gjuhën shqipe. Edhe pse botimi i tyre proaktiv është i detyrueshëm, kjo vetëqeverisje lokale nuk e zbaton sa duhet këtë parim të rëndësishëm në punën e administratës publike.

A jeni i informuar që Qeverisja Vendore organizon diskutime publike para miratimit të planeve dhe vendimeve të ndryshme që kanë të bëjnë me komunën tonë?



Sipas Ligjit është e paraparë që përpara se të miratohen planet dhe programet për fusha të ndryshme, projekte urbanistike, buxhete dhe akte të përgjithshme me të cilët përcaktohen të drejtat dhe detyrimet e qytetarëve, Komuna siguron pjesëmarrjen e qytetarëve të interesuar në vendimmarrje duke realizuar shqyrtime publike. Komuna paraprakisht përgatit programin e diskutimit publik dhe përcakton organin që do të udhëheqë diskutimin. Në pyetjen që i referohej shkallës së informimit të qytetarëve nëse Qeverisja Vendore organizon diskutime publike para miratimit të planeve dhe dispozitave të ndryshme që kanë të bëjnë me Komunën e Ulqinit, 57,7% e të anketuarve u shprehën se nuk janë të informuar, ndërsa 42,3% besojnë se janë të informuar. Nga këto të dhëna mund të përfundojmë se diskutimet publike në komunën e Ulqinit zhvillohen përmes një procedure jo shumë të qartë dhe kjo shkakton që një pjesë e madhe e qytetarëve të mbetet e painformuar për këto aktivitete. Ky është një lëshim tejet i madh po të krahasohet me një nga parimet kryesore të diskutimit publik, e që thotë: „organet e vetëqeverisjes vendore janë të obliguara që të mundësojnë realizimin e të drejtave dhe detyrimeve të popullatës vendore në mënyrë ligjore dhe efektive, duke respektuar personalitetin dhe dinjitetin e qytetarëve; janë të detyruar që t'u japin qytetarëve të dhënat e nevojshme, sqarime dhe njoftime, për të realizuar të drejtat e tyre (dhënia e njoftimeve arrihet edhe përmes mjeteve teknike, broshurave dhe mediave)”⁵ e ngjashëm.

Prandaj, mund të themi që mungon përfshirja aktive e qytetarëve në procesin e vendimmarrjes dhe “dëgjimi” i rregullt i problemeve të tyre, si dhe qasja proaktive e Komunës së Ulqinit. Përveç faktit se qytetarët nuk janë informuar sa duhet për punën e Pushtetit Vendor, shumica e qytetarëve nuk janë të informuar për rëndësinë dhe domosdoshmërinë që përmes pjesëmarrjes në shqyrtime publike të përfshihen në mënyrë efektive në procesin e vendimmarrjes. Si rrjedhojë e kësaj, pjesëmarrja e drejtpërdrejtë e qytetarëve në procesin e vendimmarrjes si dhe qasja e pushtetarëve vendorë në Ulqin, është në nivel shumë të ulët.



³ Në Komunën e Ulqinit, si gjuha dhe shkrimi malazias ashtu edhe gjuha dhe shkrimi shqip janë në përdorim zyrtar të barabartë. Neni 10, Statuti i Komunës së Ulqinit ("Fleta Zyrtare e Malit të Zi – dispozitat komunale", nr. 048/19 të datës 26.11.2019)

⁴ Analiza është realizuar në kuadër të projektit „Gjuha ime – gjuhë e barabartë” të mbështetur nga Ministria për të Drejtat e Njeriut dhe të Pakicave e Malit të Zi, në kuadër të Programit për zhvillimin dhe avancimin e të drejtave të popujve pakicë dhe bashkësi tjera etnike. E qasshme në: <https://bit.ly/3eXkzb0>

⁵ Ligji për Vetëqeverisjen Vendore, Neni 169, 170, Fleta zyrtare, nr. 2/2018, 34/2019 dhe 38/2020.



A jeni konsultuar ndonjëherë në fazën e hartimit të ndonjë vendimi/plani lokal?



Pjesa më e madhe e qytetarëve (85,6%) theksojnë se kurrë nuk janë konsultuar nga Qeverisja Vendore – Komuna e Ulqinit, gjatë përpilimit të ndonjë dokumenti apo akti vendor. Sikur edhe të pyetja e mësipërme, ashtu edhe nga të dhënat e kësaj pyetjeje, mund të përfundojmë se veprimi i Qeverisjes Vendore në fushën e konsultimit të qytetarëve është i pamjaftueshëm.

Domethënë, hapja e diskutimeve publike për pjesëmarrjen e qytetarëve në hartimin e një dokumenti ose akti vendor, është mundësi për të shprehur pikëpamje, për të propozuar ndryshime dhe për të dhënë komente për çështjet e rëndësishme të komunitetit vendor. Megjithatë, mënyra se si organizohen diskutimet publike nuk duket e pranueshme dhe e përshtatshme për publikun e interesuar.

Duke iu referuar parimeve të qeverisjes së mirë të SIGMA-s: “politikat dhe legjislacioni janë hartuar në mënyrë gjithëpërfshirëse që mundëson pjesëmarrjen aktive të shoqërisë”, dhe duke u bazuar në Strategjinë e Reformës së Administratës Publike të Malit të Zi 2016-2020⁶ dhe Planit të Veprimit për zbatimin e strategjisë⁷, është vënë në dukje masa “rritja e nivelit të pjesëmarrjes së publikut të interesuar në procesin e krijimit të akteve të politikave publike”. Është e qartë se Komuna e Ulqinit mbetet prapa në zbatimin efektiv të këtyre dokumenteve.

Si i paraqitni/artikuloni nevojat tuaja te organet e Administratës Vendore?



Iu drejtohem personalisht shërbimeve të Komunës



Përmes OJQ-ve



Nuk di si ta bëj këtë



Tjetër

⁶ Strategjia e Reformës së Administratës Publike në Mal të Zi 2016-2020 <https://bit.ly/30X5t1L>

⁷ Plan i Veprimit 2018-2020, për zbatimin e Strategjisë së Reformës së Administratës Publike <https://bit.ly/2YgWFSr>



Me anë të këtyre rezultateve mund të shihet se ekziston një gatishmëri dhe motivim i qytetarëve, që në një masë më të madhe, t'u drejtohen drejtpërdrejt dhe me vetiniciativë autoriteteve vendore. Sidoqoftë, aspekti dhe mënyra e veprimit të tyre, përkatësisht përfshirja e qytetarëve në procesin e zgjidhjes së problemeve është shqetësuese, sepse asnjë nga këto forma nuk bazohet në mekanizmat e demokracisë pjesëmarrëse. Ajo që bie në sy është mosfunksionimi i "bashkësive lokale", të cilat si forma ekzistuese të pjesëmarrjes qytetare, duhet të paraqesin një lidhje efektive midis interesave të qytetarëve dhe pushtetit vendor.

Përqindja prej 72% e qytetarëve, të cilët janë deklaruar se nevojat e tyre i adresojnë përmes organizatave të shoqërisë civile, tregon për besimin e ndërtuar të tyre kundrejt OJQ-ve lokale, gjegjësisht tregon se qytetarët besojnë se sektori civil është një aktor domethënës në procesin e përfaqësimit të interesave të një publiku të gjerë.

Gjithashtu, kjo tregon edhe një mungesë të theksuar të aktivizmit qytetar, respektivisht, mungesë bashkëpunimi midis sektorit civil dhe institucioneve publike vendore dhe përfshirjes së tyre në procesin e vendimmarrjes, siç është shënuar edhe në Raportin e fundit të Komisionit Evropian për Malin e Zi.

A jeni përpjekur (ju personalisht ose në grup me qytetarë të tjerë) të ndërmerrni një iniciativë për zgjidhjen e ndonjë problemi në vendbanimin/lagjen tuaj, në vitet e fundit?



Për zgjidhjen e cilitdo problem në vendbanimin apo lagjen ku jetojnë, qytetarët mund të ndërmarrin iniciativë dhe të kërkojnë zgjidhje në lidhje me infrastrukturën (**rrugët, trotualet e ngjashëm**), **problemet komunale (pastërtia, vendparkimet, komunikacioni/trafiku etj.)**, **problemet e mjedisit jetësor, kanalizimit, ujësjellësit dhe ngjashëm**⁸.

Në krahasim me hulumtimet e mëparshme⁹, është e dukshme rritja konstante e përqindjes së qytetarëve, të cilët ndërmarrin dhe/ose marrin pjesë në nisma të ndryshme për zgjidhjen e problemeve të tyre. Kështu, p.sh., në vitin 2011 kjo përqindje përbënte 23%, derisa pas 9 vitesh është dyfishuar dhe arrinë 46,6%. Vlerësojmë se ky rezultat është tregues domethënës i punës dhe veprimit efektiv dhe të besueshëm të OJQ-ve lokale. Por, fakti se 53,4% e të anketuarve kanë pohuar se nuk janë përpjekur të ndërmarrin ndonjë nismë, flet shumë për hapësirën e gjerë për të ndërvepruar dhe për t'u angazhuar të gjithë aktorët e komunitetit lokal.


⁸ Statuti i Komunës së Ulqinit, neni 150 ("Fleta zyrtare e Malit të Zi – dispozitat komunale", nr. 048/19 të datës 26.11.2019)

⁹ Publikimi „Pjesëmarrja e Qytetarëve në Realizimin e Vetëqeverisjes Vendore (2011)” <https://bit.ly/3gyZ0yr>



Nga rezultatet e mësipërme mund të përfundojmë se gjysma e qytetarëve dhe qytetarëve të Komunës së Ulqinit kanë ndërmarrë, gjegjësisht janë të gatshëm, që me diturinë, aftësitë dhe aktivitetin e tyre t'i kontribuojnë komunitetit lokal në zgjidhjen e problemeve dhe çështjeve me interes të përgjithshëm. Prandaj, është e nevojshme të fuqizohet besimi dhe bashkëpunimi i ndërsjellë midis qytetarëve, shoqërisë civile dhe institucioneve të qeverisjes vendore në mënyrë që të fillojë të funksionojë parimi i përgjegjshmërisë dhe i demokracisë pjesëmarrëse.

A jeni ftuar ndonjëherë (ju personalisht) apo keni parë ndonjë thirrje publike nga Komuna, që qytetarët të marrin pjesë me propozimet dhe komentet e tyre në planifikimin ose marrjen e një vendimi?




Pjesa më e madhe e të anketuarve (63,9%) deklaruan se „kurrë nuk janë ftuar personalisht” nga ana e Komunës, që përmes propozimeve dhe komenteve të marrin pjesë në planifikimin dhe marrjen e ndonjë vendimi, ndërsa vetëm 2,9% e tyre janë ftuar personalisht. Një e treta e të anketuarve (33,2%) kanë theksuar se i kanë parë thirrjet e publikuara nga Administrata Vendore.

Sipas këtyre të dhëna, mund të përfundojmë se Administrata Vendore nuk është proaktive në nxitjen e qytetarëve për pjesëmarrje në diskutime publike, gjë që tregon se Qeverisja Vendor nuk i përdor mjaftueshëm mekanizmat me të cilat drejtpërdrejt dhe/apo tërthorazi mund të nxisë qytetarët për të marrë pjesë në procesin e përpilimit dhe sjelljes së vendimeve me interes të përbashkët.

Nëse kjo përgjigje i bashkohet asaj të “gatishmërisë së qytetarëve që personalisht të kontaktojnë përfaqësuesit e tyre në Vetëqeverisje Vendore”, atëherë mund të përfundohet se qytetarët dhe qytetarët presin të jenë të përfshirë në të gjitha fazat e vendimmarrjes në komunitetin e tyre.

Nëse përgjigja juaj është „c“, na tregoni ku e keni parë ose lexuar thirrjen për diskutim publik?





Mostra e të anketuarve N=26

Një e treta e qytetarëve të anketuar (33,2%) theksuan se kanë parë thirrjen nga ana e Komunës. Këtë lajmërim/thirrje shumica e tyre e kanë parë në **rrjete sociale (15,9%), për të vazhduar më tej me televizionin apo radion lokale (11,5%), faqen zyrtare të internetit të Komunës së Ulqinit (9,1%), shtypin ditor (3,4%), ndërsa vetëm 2,4%** thirrjet i kanë parë në tabelën e shpalljeve në godinën e Komunës.

Bazuar në këto të dhëna mund të përfundojmë se thirrjet ose lajmërimet që publikohen nga ana e Komunës së Ulqinit kanë mundësinë më të madhe që të përçohen tek qytetarët nëse publikohen në rrjete sociale dhe portale apo edhe në televizionin lokal.



A keni pasur ndonjë rast që problemet aktuale t'ia paraqisni Kryetarit të Komunës?



Rreth 83% e të anketuarve kanë theksuar se nuk kanë pasur rast që kryetarit të Komunës t'ia parashtojnë problemet aktuale, derisa çdo i 6-ti qytetar i anketuar tashmë ka qenë në atë pozitë.

Përqindja e madhe e qytetarëve që kanë deklaruar se nuk e kanë pasur atë mundësi, tregon faktin se Qeverisja Vendore nuk ka punuar sa duhet në krijimin e mekanizmave të përshtatshëm që qytetarët të paraqesin problemet e tyre duke kontaktuar direkt me krerët e Komunës.

Për cilat çështje do të dëshironit që Pushteti Vendor t'ju konsultonte – të merrte mendimin tuaj?

- 1 **Infrastruktura** (rrugët, trotualet, rregullimi i qytetit)
- 2 **Problemet komunale** (vendparkimet, komunikacioni, tregu, plehrat, zhurma akustike)
- 3 **Ujësjiellësi, kanalizimi, mbrojtja e ambientit**
- 4 **Problemet e të rinjve**
- 5 **Jeta kulturore e qytetit**
- 6 **Avancimi i bujqësisë** (zhvillimi rural)



Nga tabela e mësipërme mund të shohim temat që të anketuarit i kanë renditur subjektivisht sipas rëndësisë që paraqesin për ta, gjegjësisht në tabelë renditen temat apo çështjet me interes të veçantë dhe për të cilat qytetarët do të donin të merrnin pjesë në vendimmarrje në lidhje me to. Tri temat e renditura të parat në listë, për të cilat qytetarët do të donin të përfshiheshin në vendimmarrje janë: infrastruktura (rrugët, trotualet, rregullimi i qytetit), problemet komunale (pastërtia, vendparkimet, komunikacioni, zhurma akustike, plehrat, tregjet) dhe ambienti jetësor, ujësjellësi dhe kanalizimi.

Arsyet e pakënaqësisë së qytetarëve me gjendjen aktuale dhe punën e Komunës, duhet patjetër të kërkojnë tek nevoja dhe dëshira e tyre për t'iu marrë mendimi dhe për t'u konsultuar kur bëhet fjalë për zhvillimin e komunitetit të tyre.

Edhe pse problemet e të rinjve, jeta kulturore e qytetit dhe avancimi i bujqësisë janë parë më pak të vlerësuara, është e sigurtë që ata kanë ngelur nën hijen e sfidave dhe çështjeve parësore të qytetarëve të bashkësisë lokale.

Në kuadër të kësaj pyetjeje qytetarët kanë pasur mundësinë që me ndihmën e opsionit „Diçka tjetër“, të listojnë çështjet me interes të veçantë për ta e që nuk ishin ofruar si përgjigje alternativë. Ndër të tjera, në këtë opsion qytetarët numëruan: „ofertë turistike më të mirë“, „efikasiteti i administratës publike“, „arsimi“, „politika sociale“ etj.

A e dini se qytetarët e Komunës sonë mund të marrin pjesë drejtpërdrejt në procesin e vendimmarrjes së Vetëqeverisjes Lokale?



Fakti që vetëm 28,8% e të anketuarve e dinë që mund të marrin pjesë drejtpërdrejtë në procesin e vendimmarrjes së Vetëqeverisjes Vendore është dekurajues dhe paraqet një hap mbrapa në krahasim me hulumtimet e mëparshme. Kështu, për shembull, në një anketim të realizuar në vitin 2004, 46% e të anketuarve theksuan se e dinin se mund të ndikojnë në procesin e vendimmarrjes në qeverisjen e tyre lokale.

Edhe në hulumtimin e vitit 2011 përqindja e atyre që mendonin se me aktivizimin e vet „nuk mund të ndryshonin gjë“ ishte e lartë (43%).

Duke pasur parasysh përqindjen e madhe të mbështetjes që pushteti vendor ka në Kuvendin e Komunës, është më se e pritshme që qytetarët të jenë të përfshirë më fuqishëm në procesin e krijimit të politikave dhe të marrjes së vendimeve.


Humbja e besimit të qytetarëve në mundësinë që me angazhimin e tyre të ndryshojnë diçka në komunitetin lokal, apatia dhe indiferenca e tyre, do të duhej të përceptohej si një alarm për të gjithë vendimmarrësit në nivelin lokal.

Në vazhdim të pyetësorit vijoi pyetja e radhës (12) që qytetarët të „listojnë cilët janë mekanizmat që ata mund të përdorin për të marrë pjesë në procesin e vendimmarrjes“.

Mekanizmat sipas shumicës së qytetarëve janë: 1) Iniciativat, (2) Peticionet, (3) Diskutimet publike, (4) Pjesëmarrja në tubimet qytetare, (5) Dhënia e propozimeve, (6) Protestat e ngjashëm.




Në përgjithësi, sa besoni në punën e këshilltarëve të përbërjes aktuale të Kuvendit të Komunës?



Tre të katërtat e qytetarëve të anketuar (74,1%, përkatësisht shuma kumulative e përgjigjeve "kryesisht nuk besoj" dhe "nuk besoj aspak"), theksuan se nuk kanë besim në punën e këshilltarëve të përbërjes aktuale të Kuvendit të Komunës së Ulqinit. Një e katërta e qytetarëve të anketuar deklaruan se besojnë në përfaqësuesit e tyre të zgjedhur në Kuvendin Lokal.

Nëse përmendim edhe faktin se shumica aktuale e përbërjes së Kuvendit të Komunës së Ulqinit, numëron 30 nga gjithsej 33 këshilltarë të Parlamentit Lokal (91%), mund të nxjerrim përfundimin i cili tregon se politkbërësit lokal kanë luajtur me besimin e qytetarëve dhe qytetareve të Komunës së Ulqinit.

Si e vlerësoni punën e kryetarit të Komunës?



Në fund të pyetësorit, qytetarëve të anketuar iu kërkua të vlerësojnë punën e kryetarit aktual të Komunës së Ulqinit. Nga rezultatet e fituara përfundojmë se 43,8% e kanë vlerësuar punën e tij të dobët, çdo i pesti ka theksuar se puna e tij është e nivelit „mjaftueshëm” dhe „mirë”, çdo i dhjeti vlerëson se kryetari punon „shumë mirë”, ndërsa 3,4% konsiderojnë se kryetari e kryen punën e tij „shkëlqyeshëm”. Nota mesatare e punës së kryetarit të Komunës së Ulqinit sipas këtij hulumtimi është **2.01**¹⁰.

¹⁰ Vlerësimet e fituara (nga 1 - dobët deri në 5 - shkëlqyeshëm) për punën e kryetarit të Komunës së Ulqinit për nevojat e këtij hulumtimi janë mbledhur, është gjetur mesatarja aritmetike e tyre dhe kështu kemi fituar notën e përgjithshme mesatare.

Përfundimet dhe rekomandimet

Përfshirja e qytetarëve në procesin e krijimit të politikave lokale dhe lidhshmëria e tyre me vendimarrësit paraqet shtyllat themelore të një vetëqeverisjeje lokale të përgjegjshme. Hulumtimi mbi besimin e qytetarëve në Vetëqeverisjen Vendore të realizuar me një mostër përfaqësuese, tregoi se qytetarët në përgjithësi kanë shumë vërejtje dhe kritika për punën e saj.

Nga hulumtimi mund të përfundohet se Qeverisja Vendore përpiqet që në mënyrë formale t'i përfshijë qytetarët në procesin e vendimmarrjes përmes diskutimeve publike. Si rrjedhojë, Qeverisja Vendore respekton dispozitat ligjore në lidhje me diskutimet publike, por vlefshmëria e këtyre seancave është diskutabile për sa i përket respektimit të parimeve të transparencës dhe llogaridhënies, veçanërisht duke pasur parasysh veçantitë e komunës së Ulqinit, të cilat vërehen në përdorimin e gjuhës shqipe në formën e folur dhe të shkruar, në punën e Administratës Vendore.



Rezultatet e hulumtimit tregojnë si në vijim:

- ekziston një interesim i madh i qytetarëve për punën dhe funksionimin e Qeverisjes Vendore;
- pjesa më e madhe e të anketuarve janë shprehur se nuk janë të lajmëruar rreth aktiviteteve me interes të përbashkët që ndërmerr Vetëqeverisja Vendore;
- qytetarët nuk janë mjaftueshëm të informuar nëse Vetëqeverisja Vendore organizon diskutime publike para miratimit të planeve dhe sjelljes së vendimeve që kanë të bëjnë me Komunën e Ulqinit;
- pjesa më e madhe e të anketuarve theksojnë se kurrë nuk janë konsultuar në fazën e përpilimit të ndonjë dokumenti apo akti vendor nga ana e Qeverisjes Vendore;
- në të shumtën, qytetarët e Ulqinit i drejtohen personalisht organeve të Komunës, por drejtohen edhe përmes organizatave joqeveritare, rrjeteve sociale, këshilltarëve, përmes mediave, partive politike dhe përmes "njohjeve" që kanë në Komunë;
- është e dukshme rritja e vazhdueshme e përqindjes së qytetarëve të cilët ndërmarrin ose marrin pjesë në iniciativa për të zgjidhur problemet e tyre, e që në krahasim me vitin 2011, kjo përqindje është dyfishuar dhe tani është 46,6%;
- gjysma e të anketuarve janë iniciues, gjegjësisht janë të gatshëm, që me njohuritë, aftësitë dhe aktivizmin e vet, t'i japin kontribut komunitetit lokal në zgjidhjen e problemeve dhe çështjeve me interes të përgjithshëm;
- pjesa më e madhe e të anketuarve janë deklaruar se "kurrë nuk janë ftuar personalisht" nga ana e Komunës, që përmes konsultimeve dhe sugjerimeve, të marrin pjesë në planifikimin dhe sjelljen e ndonjë vendimi;
- tri të katërtat e qytetarëve të anketuar kanë theksuar se kanë parë shpalljet publike të Komunës dhe këtë më së shumti përmes rrjeteve sociale, për të vijuar më pas me televizionin dhe radion lokale, faqen zyrtare të internetit të Komunës së Ulqinit, shtypin ditor, derisa më së pakti ndiqet tabela e njoftimeve në hapësirat e godinës së Komunës;



- shumica e pjesëmarrësve të anketimit nuk kanë pasur mundësi t'i paraqesin problemet aktuale karshi kryetarit të Komunës;
- Qeverisja Vendore nuk ka punuar mjaftueshëm në krijimin e mekanizmave të përshtatshëm që qytetarët, përmes kontaktit të drejtpërdrejtë me krerët e Komunës, të paraqesin shqetësimet e veta;
- si tri çështjet kryesore, qytetarët kanë përzgjedhur: infrastrukturën (rrugët, trotualet, rregullimi i qytetit), problemet komunale (pastërtia, vendparkimet, komunikacioni, zhurma akustike, plehrat, tregjet) dhe ambientin jetësor, ujësjellësi dhe kanalizimi;
- qytetarët janë përgjithësisht të njoftuar me mekanizmat që mund të përdorin për të marrë pjesë në procesin e vendimmarrjes;
- tri të katërtat e qytetarëve të anketuar nuk kanë besim në punën e këshilltarëve të përbërjes aktuale të Kuvendit të Komunës së Ulqinit;
- qytetarët e anketuar e vlerësojnë punën e Kryetarit të Komunës së Ulqinit me notën mesatare **2,01**.

Me qëllim të përmirësimit të kushteve për pjesëmarrjen e qytetarëve në procesin e vendimmarrjes, si dhe përmirësimit të informimit të qytetarëve rreth çështjeve publike me rëndësi për jetën e tyre në nivel lokal, si dhe me qëllim të progresit në cilësinë e shërbimeve të Komunës në nivelin lokal, propozojmë:

- të merren masa për forcimin e demokracisë pjesëmarrëse në nivelin lokal;
- të intensifikohet bashkëpunimi midis sektorit civil dhe pushtetit lokal me qëllim të adresimit të interesave të komunitetit lokal;
- të ndërmerren hapa konkrete me qëllim të informimit më të efektshëm të qytetarëve rreth aktiviteteve të Komunës me interes për komunitetin lokal, e posaçërisht rreth shqyrtimeve publike;
- të respektohen normat kushtetuese dhe ligjore, gjegjësisht të respektohet përdorimi i gjuhës së popullatës shumicë (në këtë rast përdorimi i gjuhës shqipe) nga ana e Vetëqeverisjes Vendore;
- të vendoset qasja proaktive e Qeverisjes Vendore në fazën e konsultimit të qytetarëve dhe përdorimi i mekanizmave për të inkurajuar qytetarët të marrin pjesë në procesin e përpilimit dhe marrjes së vendimeve me interes të përbashkët;
- të fuqizohet roli dhe funksionimi i bashkësive lokale;
- të publikohen buletinet vjetore rreth punës së organeve të Vetëqeverisjes Vendore;
- të futet në përdorim praktika pozitive "dyert e hapura" për qytetaret dhe qytetarët e komunës së Ulqinit.



HORIZONTI I RI (HR) u regjistrua më 6 shtator 1999 me seli në Ulqin, menjëherë pasi Mali i Zi miratoi Ligjin e parë për Organizatat Joqeveritare.

Organizata jonë, gjatë dy dekadave, ka vepruar në mënyrë aktive për forcimin e demokracisë lokale dhe zhvillimin e shoqërisë civile në një komunitet të vogël e specifik.

Horizonti i Ri angazhohet për një ndikim më të madh të qytetarëve e veçanërisht të të rinjve, në proceset e vendimmarrjes në nivelin lokal. Njohuritë dhe përvojën tonë e ndajmë me të tjerët dhe vazhdimisht përqafojmë risitë në procesin e ndërtimit të një shoqërie civile të përgjegjshme.

Vizioni jonë është një komunitet aktiv, qytetarët e të cilit kanë një ndjenjë të zhvilluar të respektit, përkatësisë dhe solidaritetit reciprok dhe të cilët angazhohen për të mirën e përbashkët.

Projektet e OJQ-së "Horizonti i Ri" kanë për qëllim inkurajimin e të rinjve për të marrë pjesë në procesin e hartimit të politikave publike lokale, forcimin e dialogut ndërkulturor dhe marrjen e përgjegjësisë për planifikimin dhe zhvillimin e komunitetit.

Organizata jonë përpiqet të krijojë breza të suksesshëm të liderëve rinorë, por mbi të gjitha, qytetarë të ndërgjegjshëm e të përgjegjshëm të shoqërisë sonë. HR ndërton me sukses partneritete dhe realizon projekte edhe në fushën e monitorimit të punës së administratës publike, transparencës dhe përgjegjshmërisë në shpenzimin e fondeve publike, si dhe nxitjen e zbatimit të Reformës së Administratës Publike në nivelin lokal.

Për 21 vite punë aktive, Horizonti i Ri ka arritur të ndërtojë imazhin e një OJQ-je të suksesshme në komunitetin lokal. HR vazhdimisht ka qenë një vendtakim për OJQ-të lokale dhe ka shërbyer si pikë referimi për vizitat e përfaqësuesve të organizatave të tjera nga Mali i Zi dhe rajoni.

Horizonti i Ri ka disa vite që luan rolin e Qendrës Lokale të Resurseve për OJQ-të lokale, por gjithashtu shërben edhe si një urë e mirë lidhëse midis autoriteteve vendore e institucioneve shtetërore me organizatat lokale të shoqërisë civile.



NEW HORIZON
Civil Society Organization



+382 68 300 603



www.ngo-horizonti.org



New Horizon NGO



ngohorizonti@t-com.me



[newhorizonngo](https://www.facebook.com/newhorizonngo)



[newhorizon_ngo](https://www.instagram.com/newhorizon_ngo)